

LLOZI- Projekti i bursave për studentë nga familje me të ardhura të ulëta mujore

EVN Maqedoni ShA, Shkup shpall konkurs për shpërndarjen e bursave për studentë nga drejtimet e Energjisë, të cilët të ardhurat mujore në familje (prindërit / kujdestarët dhe kandidati) për vitin 2020 në të gjitha kushtet nuk i kalojnë 400,000.00 denarë.

Këtë vit, do të shpërndahen 10 (dhjetë) bursa për student të cilët në vitin shkollor 2021/2022 janë regjistruar për herë të parë në vit të I, II, III, dhe IV në Drejtimet e Energjisë në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Teknologjive të Informacionit në UKIM, Fakultetin Teknik – Bitollë dhe Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike në Universitetin "Goce Delçev" – Shtip.

Bursa është në vlerë prej 8,000,00 denarë në muaj dhe jepet për 10 (dhjetë) muaj, me mundësi vazhdimi ose ndërprerje, në varësi të përmbushjes së detyrimeve të përcaktuara në Kontratën e Bursës.

Detyrimet e shfrytëzuesit të bursës:

- Të përfundon vitin shkollor në kohë
- Të ketë kaluar të paktën 70% të provimeve nga vitet e kaluara për të vazhduar bursën
- Të zbaton praksën së paku 30 ditë gjatë vitit në EVN Maqedoni ShA Shkup, dmth në Kompanitë në të cilat EVN Maqedoni është partneri dhe themeluesi i vetëm

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Biografi e shkurtër (CV)
- Vërtetim për studentë të regullt të regjistruar në semestrin dimëror në vitin akademik 2021/2022
- Certifikatë / Vërtetim nga Zyra e të Ardhurave Publike, për të ardhurat e realizuara në baza të ndryshme për vitin e kaluar për të dy prindërit - kujdestarë të kandidatit, individualisht dhe për kandidatin
- Deklaratë që nuk jeni shfrytëzues i ndonjë burse ose kredie nga ndonjë institucion ose kompani tjetër
- Deklarata e pajtimit për përpunimin dhe përdorimin e të dhënave tuaja personale dhe të dhënave nga familja juaj e ngushtë për qëllimet e bursës
- Esey mbi temën "Ardhmëria ime si inxhinier elektrik"

Dërgo të gjitha dokumentet e nevojshme në stipendii@evn.mk me një mbishkrim në **subject: për bursë**, jo më vonë se **30.10.2021**